



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 542/1 prot.

Tiranë, më 13. 04. 2022

V E N D I M

Nr. 71, datë 13. 04. 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 57, datë 31.03.2022, e K. N., ku pretendohet diskriminim për “çdo shkak tjetër¹”, nga ana e Degës Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë².

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, referuar në formularin e ankesës së depozituar pranë Komisionerit ka pretenduar ndër të tjera se: “Jam trajtuar me banesë në vitin 1995, në një pallat që filloi të ndërtohej nga Ndërmarrja e Gjeologjisë, ku unë kam qenë dhe vazhdoj të jem e punësuar. Para vitit 1995 kemi jetuar në një banesë shtetërore (pronë e shtetasit S. P.), e cila u ishte konfiskuar pronarëve të ligjshëm si tatim luftime. Pas vitit 1992, ish-pronarëve ju njoh e drejta e pronës mbi shtëpinë ku ne banonim. Për këtë arsye dolëm të pastrehë.

Jemi regjistruar si të pastrehë, pranë Bashkisë Korçë në seksionin e Shërbimeve sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.49, datë 29.01.1993 dhe jemi cilësuar si të pastrehë të Kategorisë së Parë. Nisur nga ky fakt, Drejtoria e Ndërmarrjes Gjeologjike Korçë, më trajtoi me një apartament në banesën e filluar prej saj, dhe përfunduar nga Enti Kombëtar i Banesave. Kontrata e parë është lidhur midis Entit të Banesave Korçë dhe në datë 30.08.1995.

Para se të lidhej kjo kontratë kemi plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe kemi paguar këstin e parë prej 90 000 lekësh. I gjithë ky dokumentacion gjendet në dosjen time, pranë Entit të Banesave në Korçë.

Në datë 10.05.1999, midis Entit të Banesave Korçë dhe K. N. & A. N. nënshkruhet kontrata e dytë, sipas së cilës përfitojmë një zbritje, sepse kemi patur statusin si të pastrehë (pika

¹ Strehimi.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën EKB Korçë

4a, form. 10). Kontrata është e noterizuar dhe ndodhet në dosjen time pranë Entit të Banesave në Korçë.

Në datë 10.09.2001, nënshkruhet kontrata e tretë e noterizuar midis Entit të Banesave Korçë në rolin e shitësit dhe Kozeta & A. N. në rolin e blerësit. Objekti i kësaj kontrate është zbritja nga çmimi i shitjes së apartamentit, në kontratën e shitjes me këste, Nr.1634 Rep. dhe Nr.Kol. 796, dt. 10.05.1999 e lidhur para noterit, si rezultat i zbatimit të ligjit Nr. 8030, dt. 15.11.1995 “Për kontributin e Shtetit për Familjet e Pastreha”, ndryshuar nga ligji nr. 8647, datë 24.07.2000.

Pas shlyerjes së detyrimit të kredisë, jam paraqitur pranë Degës së Entit të banesave në Korçë, që sipas kontratave të nënshkruara të fillojë aplikimi për regjistrimin e banesës. Por, po has vështirësi, sepse Përgjegjësi I. K. refuzon me arsyemin se nuk gjenden listat emërore me familjet e pastreha të shpallura me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe për këtë arsye, sipas Entit të Banesave, vihet në pikëpyetje zbritja e përfutuar nga kontrata e dt. 10.09.2001 në zbatim të ligjit Nr. 8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e Shtetit për Familjet e Pastreha”, të ndryshuar, gjë e cila nuk është përgjegjësi e familjes time.

Theksojmë se ne kemi jetuar në një banesë që i është rikthyer ish-pronarit. Statusi ynë i të pastrehit vërtetohet nga Vërtetimi i datë 10.07.2001, lëshuar nga Bashkia Korçë. Vërtetimi tregon për praninë e familjes tonë në listën e familjeve të pastreha.

Gjithashtu, duhet të theksoj edhe një fakt tjetër, i cili vërteton se ne jemi në të drejtën tonë dhe që konfirmohet lehtësisht nga dokumentacioni që disponon Dega e Entit të Banesave në Korçë.

Para viti 1995 në banesën me ish-pronar, kemi jetuar dy familje të veçanta, prindërit e bashkëshortit edhe ne. Edhe ata janë trajtuar sipas ligjit për të pastrehet me statusin “Të pastrehë të Kategorisë së Parë”, të cilin e gëzojnë me të drejtë të plotë. Banesa është përfutuar me emrin e nënës së bashkëshortit, sepse babai kishte nderruar jetë. Si ka mundësi njëra familje e gëzon statusin dhe tjetra jo?

Duhet theksuar, se në të njëjtin pallat, tek hyrja e UIK (Uzina e Instrumentave të Precizionit, Korçë), 5 familje me kushte të njëjta me të miat, e kanë regjistruar banesën e tyre, ndërsa familja ime, jo! Për çfarë arsye? Përse Enti i Banesave në Korçë nuk punon me të njëjtin standard për të gjithë qytetarët me kushte të njëjta?”.

Përsa më sipër, ankuesja ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese nga ana e Dëges Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen

ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7/1 i LMD-së³, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në vijim, ankuesja me e-mail-in datë 07.04.2022, të dërguar në adresën e KMD-së: info@kmd.al, ka kërkuar të tërheqet nga ankesa, pasi problemi i saj është duke u zgjidhur nga ana e subjektit ndaj të cilit ka paraqitur ankesën.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Përfundimi i procedurës administrative: 3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Tërheqja e kërkesës.....: 1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga K. N., e cila me anë të kërkesës me e-mail, datë 07.04.2022 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 10 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 57, datë 31.03.2022, paraqitur nga K. N., kundër Degës Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë, për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Çdo shkak tjetër)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)